



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.

Me shkresën nr. 168/5, datë 08.05.2023 “Njoftim përqendrimi dhe kërkesë për autorizim të përqendrimit”, jemi njoftuar se shoqëria Statkraft UK Ltd ka lidhur “Marrëveshje për blerje aksionesh”, datë 18 prill 2023.

Referuar “Marrëveshjes së blerjes së aksioneve”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Statkraft UK Ltd është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit anglez, e angazhuar në biznesin e zhvillimit dhe operimit të projekteve të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, gjenerimit dhe tregtimit të energjisë elektrike dhe të furnizimit me energji, e cila zotërohet 100% nga Statkraft AS, shoqëria mëmë e Grupit Statkraft, një shoqëri lider në prodhimin e energjisë hidrike në arenën ndërkombëtare dhe asaj të rinovueshme në Europë.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A., të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Shoqëritë target: Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, të themeluara sipas legjislacionit anglez, me objekt aktiviteti zhvillimi i dy fermave të prodhimit të energjisë nga era në Ishujt Shetland në Mbretërinë e Bashkuar.

Shoqëritë Target nuk janë prezent dhe nuk gjenerojnë xhiro në Shqipëri.

Pala shitëse: Peel NRE Renewables (IOM) Limited, është një shoqëri e kufizuar në aksione, e themeluar sipas legjislacionit të Isle of Man.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.